

BREAKING NEWS

x

E TRISHTË! PAS MARKO BELLOS, TJETER HUMBJE E MADHE PER POLITIKEN TONE/ C...

AKTUALITET

Krimi në familje godet sërish, gardisti qëllon për vdekje gruan, dyshonte se e tradhtonte

SHKRUAR NGA SOT.COM.AL
13 SHKURT 2019

Facebook

WhatsApp

Twitter

Email



Krimi në familje godet sërish, këtë herë në kryeqytet. Dita e djeshme do të fillonte me lajme nga kronika e zezë, ku një punonjës i Gardës së Republikës ka qëlluar me armën e shërbimit për vdekje gruan e tij. Autori është Alket Arapaj, 44 vjeç, ndërsa

viktima është Ervilma Seferaj, 36 vjeçe. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 06:00 të mëngjesit në banesën e tyre në Allias. Gardisti e ka qëlluar tre herë me armën e shërbimit gruan duke e lënë të vdekur në vend. Kanë qenë fqinjët që kanë lajmëruar policinë pasi dëgjuan të shtënat me armë zjarri dhe fëmijën duke qarë. Sipas policisë krimi ka ndodhur në momentin kur Alket Arapaj do shkonte të merrte detyrën në Gardën e Republikës. Ai shërbente prej më shumë se 20 vitesh dhe është me arsim të lartë ushtarak me gradën Kapiten. Burime bëjnë me dije se 44-vjeçari, nuk ka bërë tentativë për tu larguar nga banesa dhe ka pritur poshtë pallatit policinë. Arrestimi punonjësit të Gardës së Republikës u bë në kushtet e flagrancës nga efektivët e komisarariatit Nr.4 të policisë, në bashkëpunim me Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat. Menjëherë policia pas arrestimit të 44-vjeçarit, ngriti një grup hetimor. Por nga hetimet e kryera dyshohet se krimi fsheh pas dyshime tradhtie. Burime pranë uniformave blu thanë se motiv për krimin e rëndë mund të jetë bërë xhelozia në çift. Kjo pasi gjatë marrjes në pyetje në polici, Arapaj ka thënë se, kishte dyshime se gruaja e tradhtonte. Më tej ka shtuar se dyshimet i kanë ardhur në rritje dhe për këtë arsye ka humbur kontrollin dhe ka qëlluar në drejtim të bashkëshortes, duke e lënë atë të vdekur në vend. Burimet thonë se 44-vjeçari, nuk ka shprehur pendesë për krimin por keqardhje për vajzën e tij 4-vjeçare. “I vetmi peng që kam është vajza, të cilën e lashë rrugëve”, mësohet të ketë thënë Arapaj në polici pas krimit të rëndë. Policia tha zyrtarisht se 44-vjeçari Alket Arapaj, punonjës në Gardën e Republikës, në banesën e tij, rreth orës 06.00 të mëngjesit, me armën e shërbimit ka vrarë gruan e tij. Mësohet se Arapaj ishte besimtar mysliman dhe ndiqte rregullisht ritet fetare, ndërsa gruaja ishte e mbuluar. Prej afro 20 vitesh, ai ishte pjesë e Gardës së Republikës me gradën “Kapiten”. Fqinjët e çiftit thonë se ishin bashkëshortë model, duke u shprehur të shokuar për ngjarjen.

Fqinjët: E pabesueshme, ishin njerëz të mrekullueshëm

Çifti jetonte prej disa vitesh në katin e 4-t të një pallati, në rrugën “Vangjel Capo” në Allias. Sipas fqinjëve, 36-vjeçarja dhe bashkëshorti i saj njiheshin si familjarë të rregullt dhe madje praktikantë të fesë myslimane. Ata shprehen të tronditur nga ngjarja e rëndë. "Unë kam 50 vjet që jetoj këtu, edhe ata jetonin këtu. Nëna dhe i ati kanë ikur te djali tjetër dhe vinin në mars. Nusja dilte dhe mbushte ujë, e shikoja shpesh. Djali shkonte në punë. Kanë një vajzë 4 vjeçe. Është një ngjarje e paparë. Më vjen shumë keq, jemi të tronditur", tha njëra nga fqinjet. Ndërsa një fqinje tjetër thotë, se vajza e vogël kur doli nga banesa tha që mami po flinte. “Nuk kishim dëgjuar kurrë ndonjë grindje. Shkonin në xhami, faleshin. Vajza e vogël kur ndodhi ngjarja në shtëpi ishte, flinte gjumë ajo fëmijë. Doli në mëngjes pastaj, e mori një nga njerëzit e të shoqes. Edhe i tha burri “të keqen gjyshi. Po fle mami gjumë, ja ktheu ajo”, thotë një tjetër banore e pallatit ku banonte prej kohësh autori dhe viktima. Ndërsa një tjetër fqinje shton se ata janë familje e mrekullueshme. “Ata janë familje shumë e mirë dhe e mrekullueshme. Si Alketi dhe e shoqja janë shumë të mirë. Njerëz me fe, pasi faleshin. Jemi habitur kur jemi zgjuar. Brenda në familje nuk e di, por nuk kemi dëgjuar për grindje. Nuk e di, do të ketë qenë ndonjë moment... pa dashje, gabimisht, pasi nuk ka mundësi që ai njeri kaq i mirë të vriste”, u shpreh për gazetarët një tjetër fqinj i çiftit.

Elvis Myrta

YOU MAY LIKE

by **mgid**

**Milioner iz Beograd otkriva kako
zarađuje € 386 evra na sat**

BITCOIN ERA